



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 29 regjistër (JR)
Datë 30.05.2019

Nr. 33 i vendimit
Datë 27.11.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancën gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 27.11.2019, ditën e mërkurë, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia Roessingh, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Marsida Xhaferllari.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 115, datë 11.03.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet Ç, D, Dh, E të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, u njoh me kërkimin e subjektit të rivlerësimit për të tërhequr ankimin, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, ka ushtruar detyrën e Kryeinspektorese së Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).

Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, gjithashtu ka kandiduar për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe, në bazë të nenit 282, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”) dhe të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, miratuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi në kohë, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur në datën 30.11.2017.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 115, datë 11.03.2019, ka vendosur: “Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur”.
3. Ky vendim është marrë nga Komisioni bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
4. Komisioni, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit, ka mbështetur vendimmarrjen e tij në konkluzionin se ka qenë e pamundur të përfundohet procedura e rivlerësimit për subjektin, pasi:
 - (i) ligji nr. 84/2016 e detyron Komisionin ta bazojë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit që nuk e ka statusin e magjistratit, mbi rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
 - (ii) për sa kohë që këto rezultate nuk janë të disponueshme, trupi gjykues nuk mund të kryejë vlerësimin e aftësive profesionale dhe nuk mund të kryejë rivlerësim kalimtar për subjektin e rivlerësimit.

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit dhe procedura e shqyrtimit

5. Kundër këtij vendimi të Komisionit ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ndryshimin e vendimit nr. 115, datë 11.03.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.
6. Për këtë çështje, nga ana e Vëzhguesit Ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit Hans Kijlstra, më datë 10.07.2019, është paraqitur pranë Kolegjit kërkesa për trajtimin me procedurë të përshpejtuar të këtij ankimi.
7. Trupi gjykues i Kolegjit, më datë 26.07.2019, vendosi pranimin e kësaj kërkesë, mbështetur në nenin 20, pika 1/1, paragrafët 1 dhe 2 të rregullores së Kolegjit “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”. Ky vendim iu

njoftua edhe subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, në datën 31.07.2019, e cila konfirmoi marrjen dijeni.

IV. Në lidhje me kërkesën për heqjen dorë nga ankimi

8. Më datë 15.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka depozituar personalisht pranë Kolegjit një kërkesë “Për tërheqje ankimi”, e cila është protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 15.11.2019. Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, ka parashtruar se në pritje të shqyrtimit të ankimit nga Kolegji, një organ tjetër kushtetues, përkatësisht Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka kryer ndaj saj një proces kontrolli për tre komponentë, atë të pasurisë, të figurës dhe të profesionalizimit, për shkak të kandidimit të subjektit të rivlerësimit për pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pozicion për të cilin ajo kishte aplikuar gjithashtu. Në përfundim të këtij procesi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimet e tij përkatësisht nr. 110 dhe 111, datë 06.08.2019, ka vendosur lejimin e kandidimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, për këto dy pozicione, duke arsyetuar se ka një nivel të besueshëm në të tre komponentët e verifikuar.
9. Në kërkesë subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, argumenton se, në këtë kontekst faktesh dhe ngjarjesh, tashmë i duket e pakuptimtë t’i qëndrojnë ankimit, pasi konsiderohet se po kërkon nga organet shtetërore një rivlerësim të tretë të saj dhe se, për më tepër, statusi i saj profesional ndërkohë ka ndryshuar pasi, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11350, datë 13.11.2019, ajo është emëruar në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka bërë betimin para Presidentit të Republikës më datë 14.11.2019.
Gjithashtu, subjekti ka pretenduar në këtë kërkesë se Kolegji duhet të pushojë shqyrtimin e gjykimit të kësaj çështjeje, në zbatim të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile dhe në referim të vendimit nr. 2 (JR), datë 10.07.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

10. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi është njohur me ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, si dhe me kërkesën e saj për tërheqjen e ankimit vlerëson sa vijon.
11. Kushtetuta në nenin 179/b, pika 5 e saj parashikon: *Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...] – dhe, sipas kësaj dispozite kushtetuese, janë subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik ata që vënë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelit për kontrollin e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi bazën e ankimit të paraqitur prej tyre.*
12. Neni 179/b, pika 10 e Kushtetutës parashikon se procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
13. Në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet: *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2 i Aneksit.* Në referencë të këtyre dispozitave kushtetuese, sidomos parashikimeve në nenin 179/b, pika 10 e Kushtetutës, Kolegji çmon se instituti i heqjes dorë nga ankimi i subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, do të rregullohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Ndërsa në dispozitat e veçanta të ligjit nr. 84/2016 nuk gjenden rregullime të posaçme për t'i dhënë zgjidhje një situatë si kjo e rastit objekt shqyrtimi, Kolegji vëren se në nenin 4, pika 6 e këtij ligji, parashikohet: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.
15. Në këtë kontekst, në kushtet kur si Kushtetuta, edhe ligji nr. 84/2016 nuk i rregullojnë drejtpërdrejt procedurat në lidhje me institutin e heqjes dorë nga ankimi, në referencë të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, konkretisht të nenit 1, pika 2, ku parashikohet se: *Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për atë që ky ligj nuk parashikon ndryshe*, dhe të nenit 44 të tij, në të cilin parashikohet se: *Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj* – Kolegji çmon se për të zgjidhur situatën konkrete duhet t’u referohet dispozitave të posaçme të Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë institutin e heqjes dorë apo të tërheqjes së ankimit dhe pasojat ligjore që prodhon ushtrimi i kësaj të drejte të ankuesit.

Në këto kushte, duke konsideruar përmbajtjen e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, për të tërhequr ankimin e paraqitur prej saj kundër vendimit nr. 115, datë 11.03.2019, të Komisionit, në zbatim të parimit se ankuesi është dhe mbetet titullari i vetëm i këtij mjeti procedural për të kundërshtuar vendimmarrjet e Komisionit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, Kolegji vlerëson se gjendet para zbatimit të detyrueshëm të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet dhe rregullohet pasoja ligjore e heqjes dorë nga ankimi, sipas këtij përcaktimi: *Në çdo fazë të gjyimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.*

16. Sa më sipër, Kolegji, duke konstatuar heqjen dorë nga ankimi të subjektit të rivlerësimit, çmon se vetë Kolegji nuk ka më juridiksion të shqyrtojë çështjen për të cilën është vënë në lëvizje dhe, në zbatim të dispozitës së cituar më lart, duhet të pushojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në këtë fazë të procesit. Kolegji e sheh të nevojshme të nënvizojë faktin se e njëjta zgjidhje ligjore është mbajtur prej këtij Kolegji edhe në vendimin nr. 2 (JR), datë 10.07.2018, duke pranuar referimet për zgjidhjen e çështjes në rastin e tërheqjes së ankimit të paraqitur prej palës ankuese, pikërisht në dispozitat e cituara më lart.
17. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 dhe për të shmangur keqkuptimet rreth natyrës dhe pasojave ligjore që do të krijojë ky vendim i Kolegjit, konsideruar natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit, Kolegji gjen me vend të nënvizojë dhe të deklarojë për efekt të këtij procesi edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, i cili ishte objekti i ankimit të subjektit të rivlerësimit.

Në këtë kuptim, Kolegji, duke ndjekur të njëjtën logjikë referuese, atë të dispozitave të cituara më lart, konstaton se vendimi i Komisionit nr. 115, datë 11.03.2019, ndaj të cilit ishte ushtruar ankimi i cili u tërhoq prej subjektit të rivlerësimit, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje. Këtë situatë ligjore e rregullon qartësisht parashikimi i nenit 451, germa “b” e Kodit të Procedurës Civile, e cila përcakton: *Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr.*

18. Ndonëse forma e prerë në këtë rast vjen *ipso jure* për shkak të parashikimit ligjor, Kolegji vlerësoi ta bëjë deklarinimin e kësaj pasoje, pjesë të dispozitivit të këtij vendimi, duke konsideruar se përveç pasojave ligjore që ky vendim prodhon për palën ankuese dhe institucionet që trajtojnë çështje që lidhen me karrierën apo statusin e subjektit të rivlerësimit, ky vendim vlen edhe si komunikim me publikun dhe ka për qëllim edhe informimin e tij për vendimet që marrin institucionet e rivlerësimit në kuptim të nenit Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.
19. Përfundimisht, Kolegji, pasi e gjykoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit duhet të pushohet, për shkak të tërheqjes së ankimit prej subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 451, germa “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, kundër vendimit nr. 115, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkak të tërheqjes së ankimit.
2. Të deklarojë marrjen e formës së prerë të vendimit nr. 115, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 27.11.2019.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Natasha Mulaj dhe Rezarta Schuetz, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për zgjidhjen në themel të çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për arsyet e shtjelluara më poshtë.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka filluar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit dhe, pavarësisht se vendimi i Komisionit ka devijuar nga objekti i shqyrtimit për shkak të një rrethane të caktuar, të konstatuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, me ankimin e subjektit të rivlerësimit, është vënë në lëvizje Kolegji.
3. Në vlerësimin tonë, pas tërheqjes së ankimit nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ishte në rrethanat faktike të parashikuara nga neni G i Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, duhet të deklaronte masën e parashikuar nga pika 2 e kësaj dispozite. Konkretisht, neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon:
 - “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.
 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.
4. Përfundimi i mësipërm është rezultat i analizës dhe vlerësimit të disa aspekteve që lidhen me faktet dhe me ligjin. Së pari, kemi parasysh që në ankimin e tij voluminoz, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar pasi, në vlerësimin e tij, ai arrin nivel të besueshëm në të tria kriteret e përcaktuara në ligj, për sa i përket rivlerësimit. Me fjalë të tjera, ky subjekt ka kërkuar të ndjekë procedurat e rivlerësimit që kanë ndjekur shumica e magistratëve. Akti i tërheqjes së ankimit nga subjekti i rivlerësimit ka ardhur më 15.11.2019, menjëherë pas emërimit të tij gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga Presidenti¹ i Republikës.
5. Me betimin e kryer prej tij përpara presidentit të Republikës, subjekti i rivlerësimit hoqi dorë me veprime konkludente nga statusi i magistratit, të cilin në vlerësimin e tij vazhdonte ta gëzonte. Nga ana tjetër, ankimi kundër vendimit të Komisionit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit, përqendrohej kryesisht në argumentet dhe interpretimin e ligjit dhe të fakteve që në vlerësimin e tij binin ndesh me vendimin e Komisionit, sipas të cilit ai e kishte humbur statusin e magistratit përfundimisht në vitin 2008, me ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkonte rivlerësimin e tij kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”) si magistrat, dhe jo për shkak të detyrës së kryeinspektorit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
6. Me fjalë të tjera, në rastin konkret, çështja shtrohej nëse subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohej rivlerësimit si *magjistrat* apo si *kryeinspektor* i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Asnjë nga dy këndvështrimet nuk vinte në dyshim që procesi i rivlerësimit duhet të kryhej; në debat ishte cilësia në të cilën duhet të kryhej rivlerësimi për këtë subjekt.
7. Vendimi i marrë nga shumica përbën keqinterpretim të qëllimit të ligjit dhe zbatimit në praktikë të tij, pasi është lejuar që një individ i cili në mënyrë *nominale* është përcaktuar

¹ <http://president.al/presidenti-meta-dekretion-emerimin-e-znj-marsida-xhaferllari-gjyqtare-te-gjykates-kushtetuese/Nr.dekreti11350,Tiranë,më13.11.2019>.

nga ligji si subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit, të anashkalojë procesin e rivlerësimit. Konkretisht, neni 179/b i Kushtetutës parashikon:

“[...] 3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, *Kryeinspektorin* dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet [...]”.

8. Në rrethanat kur pikërisht dispozita kushtetuese që prezantoi konceptin e rivlerësimit dhe parimet e tij, ka parashikuar shprehimisht se për nga funksioni subjekti i rivlerësimit duhet t’i nënshtrohej rivlerësimit, në cilëndo nga tri cilësitë funksionale – si kryeinspektor, si ish-magjistrat ose si magjistrat – nëse pranohej arsyetimi i tij sipas ankimit, vlerësuar në bazë të viteve të punës si gjyqtar, pushimi i çështjes nga shumica është në kontradiktë me ligjin.
9. Neni 66 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se vendimi i Kolegjit, pas shqyrtimit të çështjes, mund të konsistojnë në: “[...] a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; c) prishjen e vendimit të Komisionit”. Në asnjë rast ligjvënësi nuk lejon si alternativë *pushimin* e gjykimit/shqyrtimit të çështjes.
10. Po ashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve u ka lejuar institucioneve të rivlerësimit dy mundësi: të rivlerësojnë subjektet që i nënshtrohen procesit ose të përjashtojnë nga mundësia e emërimit në organet e drejtësisë ata individë që vendosin të mos i nënshtrohen procesit të rivlerësimit nëpërmjet dorëheqjes nga detyra. Me vendimin e marrë nga shumica, është lejuar krijimi i një alternative të tretë, të paparashikuar nga ligji. Kjo alternativë, e paparashikuar në ligj, përfton një peshë të veçantë nëse, si në rastin konkret, zbatohet për një individ që synon të shërbejë në një institucion si Gjykata Kushtetuese, gjyqtarët e së cilës me ligj i janë nënshtrohur rivlerësimit në mënyrë të shprehur.
11. Në vlerësimin tonë, referimi në Kodin e Procedurës Civile nga shumica, në rrethanat konkrete, bie ndesh me parimet e procesit të rivlerësimit dhe parashikimet ligjore të miratuara për këtë shkak. Themë kështu sepse së pari, procesi i rivlerësimit, një proces *sui generis*, ka natyrë administrative. Neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ndër parimet e procesit të rivlerësimit, përcakton që organet e rivlerësimit mund të zbatojnë “[...] edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji [...]”.
12. Nga leximi harmonik i sa më sipër, rezulton se mbështetja në dispozitat procedurale civile vjen si alternativë e radhës së tretë, nëse procedurat e Kodit të Procedurës Administrative apo të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”) nuk mjaftojnë, dhe nëse çështja në debat mund të pranojë zbatimin e dispozitave të mosmarrëveshjeve civile mes palëve si përjashtim, për sa kohë procedurat e gjykimit administrativ nuk parashikojnë ndryshe dhe mbi të gjitha, nëse Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 heshtin për një procedurë specifike. Në rastin konkret, konsiderojmë të gabuar mbështetjen nga shumica në radhë të parë në

një dispozitë procedurale civile e cila nuk ka vend të zbatohet, bie qartësisht ndesh me kuadrin ligjor të procesit të rivlerësimit, duke qenë se lejon krijimin e një alternative të tretë, të paparashikuar në aktet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë rivlerësimin dhe bie ndesh edhe me dispozitën që përbën urën lidhëse mes procesit administrativ dhe atij civil, konkretisht me nenin 14 të ligjit nr. 49/2012. Ky i fundit parashikon shprehimisht që të drejtat dhe detyrat e palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile *për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji.*

13. Së fundmi, interpretimi i zgjedhur nga shumica bie ndesh edhe me parimin e gjykimit administrativ, të mishëruar në nenin 3, pika 2 [ligji nr. 49/2012], sipas së cilës “në gjykimin administrativ gjykata e ka për detyrë të mbrojë edhe interesin publik, bashkë me interesin e ligjshëm të personave privatë”. Mbrojtja e interesit publik krahas atij privat të ligjshëm në mënyrë të balancuar është edhe arsyeja pse, ndryshe nga mosmarrëveshjet tipike civile, në shqyrtimin administrativ, mosparaqitja e palëve në proces nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.
14. Për këto arsye, ne jemi të mendimit se tërheqja nga shqyrtimi i ankimit nga subjekti në këtë moment procedural, referuar dispozitave të mësipërme, duhej parë si heqje dorë nga procesi i rivlerësimit, si dhe si tërheqje nga statusi i magjistratit e tërheqje nga detyra dhe, si rrjedhojë, të zbatohet neni G i Aneksit të Kushtetutës.
15. Referuar sa më sipër, vlerësojmë se vendimi i Komisionit nr. 115, datë 11.03.2019, duhet të ndryshohet dhe, në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, duhet të aplikohet ndalimi, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, nuk mund të emërohet gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.

Gjyqtare

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

Gjyqtare

Natasha Mulaj

nënshkrimi